



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
Ministri

UNIVERSITETI MESDHETAR
I SHQIPËRISE
TIRANE
Nr. Prot. 196 Dt. 6.10.11

3036 /
Nr. ... Prot.
2

Tiranë, më 03.10.2011



URDHËR

Nr. 482, datë 03.10.2011

PËR

HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË "BACHELOR",
PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË "MASTER PROFESIONAL" DHE
PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË "MASTER I SHKENCAVE" NË
SHKOLLËN E LARTË PRIVATE "UNIVERSITETI MESDHETAR I SHQIPËRISË"

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; dhe të nenit 44/1 të Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar:

URDHËROJ:

1. Hapjen, në përputhje me Vendimin nr. 233, datë 16.09.2011 të Këshillit të Akreditimit, në Shkollën e Lartë Private "Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë", e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në:
 - a. "Shkenca politike dhe administrative"
 - i. "Shkenca politike"
 - ii. "Administratë publike"
2. Hapjen, në përputhje me Vendimin nr. 256, datë 16.09.2011 të Këshillit të Akreditimit, në Shkollën e Lartë Private "Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë", e programeve të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në:
 - a. "Shkenca politike dhe administrative" me profile:
 - i. "Politika sociale"
 - ii. "Administratë publike"
 - iii. "Qeverisje vendore"
 - b. "Marrëdhënie ndërkombëtare" me profile:
 - i. "Studime mesdhetare"
 - ii. "Studime europiane"




- c. "Administrim biznesi"
 - d. "Menaxhim biznesi" me profile:
 - i. "Menaxhim turizmi"
 - ii. "Menaxhim i pasurisë së paluajtshme"
 - iii. "Menaxhim arti"
 - iv. "Menaxhim shëndeti"
 - v. "Menaxhim arsimit"
3. Hapjen, në përputhje me Vendimin nr. 256, datë 16.09.2011 të Këshillit të Akreditimit, në Shkollën e Lartë Private "Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë", e programeve të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në:
 - a. "Marrëdhënie ndërkombëtare"
 - b. "Shkenca politike"
 - c. "Financë bankë"
 4. Programet e studimeve të ciklit të parë Bachelor, referuar pikës 1 të këtij urdhri, realizohet me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 vite akademike. Në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë, lëshohet diplomë universitare "Bachelor" në fushën e arsimit të kryer.
 5. Programet e studimeve të ciklit të dytë Master Profesional, referuar pikës 2 të këtij urdhri, realizohet me 90 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 1,5 vite akademike. Në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të dytë, lëshohet diplomë universitare "Master Profesional" në fushën e arsimit të kryer.
 6. Programet e studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave, referuar pikës 3 të këtij urdhri, realizohet me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike. Në përfundim të programit të studimit të ciklit të dytë, lëshohet diplomë universitare "Master i Shkencave" në fushën e arsimit të kryer.
 7. Shkolla e Lartë Private "Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë", të dërgojë në MASH, brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri, një raport për plotësimin e kushteve të vëna nga Këshilli i Akreditimit në vendimin nr. 256, datë 16.09.2011 të tij.
 8. Programet e studimeve të fillojnë në vitin akademik 2011-2012.
 9. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Këshilli i Akreditimit, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe Shkolla e Lartë Private "Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë".


Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.



MYQEREM TAPAJ
Myqerem Tapaj
MINISTËR



REPUBLICA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË
Nr. ... 227 ... Rep.



Tirane, më 13/08/2012

Vërtetim i dokumentit Njësia me Originalin

Në Tirane, sot më datën 13/08/2012 (dymije e dymbëdhjete), përpara meje Mimoza A. Papa, Noter, me seli në rrugën "Reshit Çollaku", Pallati pranë Albtelekomit, kati dytë, Zyra Nr.1, u paraqit personalisht z. Romeu Ura, banues në Tirane, madhor me zotësi të plote për të vepruar, i njohur personalisht prej meje, i cili më kërkoi vërtetimin e dokumentit original. Dokumenti nuk ka korigjime. "Vërtetohet se njësia është kopje e njëjtë me dokumentin original.

Dokumenti që vërtetohet është :

Urdher Nr.482, datë 03-10-2011, leshuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës Ministri, Nr.5056/2 prot, datë 03-10-2011, për "Shkolla e Lartë Private, Mesdhetare e Shqiperise".

Vërtetimi i dokumentit bëhet mbi bazën e Ligjit Nr. 7829, datë 01-06-1994, "Për Noterinë", Udhëzimi Nr. 6291, datë 17-08-2005, i ndryshuar me Udhëzimin Nr.7203, datë 16-09-2009, Ministrisë së Drejtësisë .

NOTER

Mimoza A. Papa

